



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 dhe neni 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur në mes të Kosova –Women 4 Women dhe Komunës së Lipjanit nr.01-300/01-13360 të datës 26.03.2025 si dhe Aneks Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur në mes të Kosova –Women 4 Women nr.01-300/01-13366 të datës 26.03.2025, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 24.04.2025, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR KOSOVA- WOMEN 4 WOMEN

I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 4.200.00 € (katër mijë e dyqind euro), Kosova-Women 4 Women, konform Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur në mes të Kosova –Women 4 Women dhe Komunës së Lipjanit nr.01-300/01-13360 të datës 26.03.2025 si dhe Aneks Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur në mes të Kosova –Women 4 Women nr.01-300/01-13366 të datës 26.03.2025.

II. Ndarja e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi bëhet me qëllim të përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur në mes të Kosova –Women 4 Women dhe Komunës së Lipjanit nr.01-300/01-13360 të datës 26.03.2025 si dhe Aneks Memorandumit të Mirëkuptimit të lidhur në mes të Kosova –Women 4 Women nr.01-300/01-13366 të datës 26.03.2025, me qëllim të bashkëfinancimit të projektit me titull “Mundësitë e përmirësuar të vetëpunësimit dhe punësimit” i cili financohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) ku planifikohet të organizohet trajnimi i grave në hortikulturë . Granti do të bashkëfinancohet nga Kosova –Women 4 Women dhe Komuna e Lipjanit varësisht nga shprehja e interesit në total shuma e projektit është deri në 9000 euro, bashkëfinancimi do të bëhet në proporcion 240.00 euro nga Kosova –Women 4 Women gjithsej deri në 4800 euro ndërsa 210.00 euro nga Komuna e Lipjanit gjithsej deri në 4200 euro.

III. Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga të hyrat vetanake të Komunës, kategoria ekonomike - subvencione dhe transfere të planifikura për vitin 2025 për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari, kodi i programit 47003, fondi burimor 21/613/47003/200/00000/0421.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa, dhe Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

15 Nr. hodo1-20987

Lipjan, më 24.04. 2025

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

